



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport– Odeljenje za Kultur, Omladinu i Sport



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

Nr. I prot. 647 Më 05.03.2019
-III- Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC

DATE/A:	01.01.2018-31.12.2018
NGA/OD/FROM:	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i punës për vitin 2018

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Në përputhje me detyrat dhe planifikimet e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Kryetarit të Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, i paraqesim këtë:

RAPORT TË PUNËS

Për periudhën janar-dhjetor 2018

Parathënie

Drejtoria në përbërje prej këtyre sektorëve; Kulturës, Rini dhe Sport, Trashëgimia kulturore-historike dhe biblioteka, me një buxhet të caktuar, mbulon fusha me rëndësi në jetën e përditshme, duke përfshirë aktivitete të ndryshme: muzikë, teatër, art figurativ, aktivitete rinore, sportive dhe ruajtja e trashëgimisë tonë historike e kulturore.
Personeli i DKRS-së ka qenë i angazhuar që të gjitha këto aktivitete të përmbushen me sukses, përkundër buxhetit të kufizuar. Mirëpo, angazhimet për sigurimin e mbështetjes financiare shtesë dhe për të siguruar mbështetje sa më të gjerë shoqërore, nuk kanë mundur.

Përveç buxhetit komunal, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për gjetjen e burimeve të tjera financiare në institucione të ndryshme, duke përfshirë ato qendrore; Ministria e Kulturës dhe donatorë të ndryshëm vendor dhe ndërkombëtar. Bashkëpunimi me këtra organizma ka qenë afatgjatë, konstruktiv dhe dobiprurës.

Në raport të punës janë të përfshira të gjitha aktivitetet të zhvilluara në drejtori, duke përfshirë aktivitete në fushën e kulturës, trashëgimisë kulturore e historike, bibliotekarisë, sportit dhe rinisë. Bashkëpunimi me OJQ-të, strukturat e pushtetit lokal, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe donatorë të ndryshëm, ka qenë konstruktiv dhe ka rezultuar me sukses në disa prej aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2018.

Çfarë kemi arritur?

Shënimet e mëposhtme përmbledhin aktivitetet kryesore dhe të arriturat e DKRS-së nga janari deri në dhjetor 2018. Informata më të hollësishme janë dhënë në aneksin e këtij raporti, që ofron informacion të hollësishëm të veprimtarisë së DKRS-së.

- Hartimi i planit të punës nga të gjithë sektorët e DKRS-së për vitin 2018.
- Planifikimi i shpenzimeve për shërbime dhe mallra për vitin 2018.
- Është realizuar takimi me sportdashës dhe udhëheqësit e kaluar të klubit të futbollit “Rahoveci” ku është bërë zgjedhja e kryesisë së përkohshme të klubit, pas një krize të gjatë që e ka përcjellë këtë klub.
- Përzgjedhja e “Sportistit të vitit 2017”
- Thirrja publike në konkursin e artit letrar dhe pamor, për nder të manifestimit përkujtimor dhe kulturor “Flaka e Janarit”.
- Përgatitjet e manifestimit tradicional “Flaka e Janarit 2018” bashkë me Komisionin organizues.
- Shpërndarja e ftesave,
- Përgatitjet teknike dhe materialet tjera informuese.
- Pastrimi dhe rregullimi i sallës (pas renovimeve të brendshme që janë bërë).
- Takim me stafin teknik të KF “Rahoveci”. Përgatitjet për sezonin e ri të garave dhe gjendja aktuale në Klub, (bashkëpunimi).
- Vizitë shtëpisë së kulturës në Ratkoc dhe konstatimi i gjendjes së rëndë teknike në objekt.
- Vlerësimi i punimeve letrare – artistike të Flakës së Janarit 2018.
- Manifestimi “Flaka e Janarit” u mbajt në kushte optimale dhe të gjitha përgatitjet ishin në nivel.
- Përgatitja e kërkesave për furnizim me libra të bibliotekave të komunës, (kërkesat janë përgatitur për: Ministrinë e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, Institutin Albanologjik, Bibliotekën Kombëtare “Pjetër Bogdani” dhe bibliotekën “Hivzi Sulejmani”.

- Plotësimi i formularit të performancës komunale për kulturë, rini dhe sport.
 - Konsultimet me stafin e kryetarit të komunës, për përgatitjen e thirrjes për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të kulturore, sportive, rinore dhe subjekteve individuale. Aplikacione të pranuar për subvencione gjithsej 36.
 - Konsultime dhe përgatitjet me këshillin organizativ për shënimin e 17 Shkurtit,
 - Planifikimi i mbajtjes së garave në futboll të vogël, për festën e 17 Shkurrit - Ditës së pavarësisë. Ekipet e paraqitura gjithsej 22.
 - Kërkesë zyres së prokurimit për hapjen e procedurave për shpalljen e tenderit për furnizim të DKRS-së me rekuizita sportive dhe material të nevojshëm administrativ.
 - Shqyrtimi i aplikacioneve të OJQ-ve kulturore, sportive dhe rinore. Aplikacione të pranuar dhe të shqyrtuara 36.
 - Në sallën e qendrës së kulturës, është mbajtur kuizi i diturisë me nxënës të shkollave të mesme dhe fillore, organizuar nga DKA për nder të 10 - vjetorit të pavarësisë.
 - Punëtorët e DKRS-së ishin të angazhuar për mbarrëvajtjen e manifestimit.
 - Drejtorja për KRS, gjegjësisht biblioteka komunale "Sulejman Krasniqi", ka pranuar një donacion solid me libra, nga dashamirësi i librit profesor Xhevdet Sadiku nga Krusha e Madhe.
 - Shënim i vitit jubilar në 10 - vjetorin e pavarësisë së Republikës së Kosovës.
 - Finalja e garave të festës së pavarësisë në qendrën sportive "Toni sport". Punëtorët e DKRS-së ishin të angazhuar për mbarrëvajtjen e manifestimit.
 - Përgatitja e propozim-vendimit për pagesën e fituesve të konkursit në artin letrar dhe atë pamor "Flaka e Janarit-2018".
 - Vizita e zyrtarëve komunal të Malishevës, të prirë nga drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport znj. Besartë Kryeziu-Ramaj
- Tema: shqyrtimi i mundësive për bashkëpunim dhe koordinim të aktiviteteve me interes të përbashkët, vizitë bibliotekës komunale Sulejman Krasniqi" dhe muzeut komunal.
- Konsultime me drejtorin e DKA-së Avni Morina dhe zyrtarë të qendrës rinore SHL-Kosova. Tema: Harmonizimi i ideve për shënimin e 7 Marsit, Ditës së Mësuesit.
 - Kemi bërë kompletimin e dokumentacioneve të nevojshme për përfituesit e subvencioneve për OJQ-të. Kulturore, Sportive dhe Rinore, të ndara nga buxheti i DKRS.
 - Drejtorja për Punë Inspektuese ka bërë kërkesë me shkrim në DKRS, për informata zyrtare për objektin e ish-stacionit policor në fshatin Ratkoc, nëse ndodhet në listën për mbrojtje të përkohshme të monumenteve të vjetra.
 - Përgatitja e mbi 150 mirënjohjeve për familjarët e dëshmorëve dhe heronjve.
 - Concert nga ShKA "Anadrini", për nder të 17 - vjetorit të themelimit të shoqatës. Punëtorët e DKRS-së ishin të angazhuar për mbarrëvajtjen e koncertit.
 - Në bashkëpunim me DKA-në do të mbahen dy aktivitete me nxënës të shkollave për nder të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit.
 - Më 6 mars, në qendrën kulturore "Mensur Zyberaj" u mbajt aktiviteti me nxënës të shkollave të mesme dhe fillore.
 - Më 7 mars, aktiviteti i radhës për nder të 7 Marsit - Ditës së Mësuesit me program kulturor nga nxënësit e shkollave të Komunës.
 - Në galerinë e qendrës kulturore, zyra për barazi gjinore në bashkëpunim me DKRS-në, ka shënuar 8 Marsin - Ditën e Gruas.

- Drejtoria ka bërë përgatitjen e kërkesës në formë projekti për pasurimin e fondit librar për bibliotekat e komunës, gjeçjesisht në emër të bibliotekës komunale “Sulejman Krasniqi”. Në kërkesë janë të përfshirë libra në vlerë prej 5.000,00€.
- Projekti financohet nga MKRS - Prishtinë. Kërkesa është realizuar gjatë muajit qershor.
- Kemi bërë kërkesë drejtorisë së financave për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 5.000,00€, kërkesë kjo që ka të bëjë me shërbimet e transmetimit të mbledhjeve të Kuvendit dhe shërbimeve tjera për komunën e Rahovecit. Kërkesa është realizuar.
- Përgatitje për shënimin e tri aktivitetëve: 1. Më 19 mars, 72- vjetori i rënies së tetë dëshmorëve të atdheut në Sferkë-Dush,
- 2. Aktivitet në partneritet me SHL-Kosova dhe
- 3. Shënim i “21 Marsit-Dita Botërore e Poezisë”, (aktiviteti realizohet në bashkëpunim me DKA dhe institucionet tjera.
- Në qendrën e kulturës u mbajt aktivitet për stimulimin dhe ngritjen e vetëdijes së nxënësve të shkollës së mesme për zgjedhjen e profesionit dhe përcaktimin për tregun e punës (Organizuar nga SHL-Kosova, DKA dhe DKRS).
- DKRS dhe DKA kanë organizuar më 21 mars “Ditën Botërore të Poezisë”, pjesëmarrës ishin nxënës, punëtor të arsimit dhe poetë.
- Ditët përkujtimore në nderim të dëshmorëve dhe martirëve të kombit në komunën tonë që nisën nga data 25 mars 2018.
- Gjatë javës, gjeçjesisht në ditën përkujtimore për të rënë të fshatit Krushë e Madhe, DKRS dhe Këshilli i fshatit Krushë e Madhe, në shtëpinë e kulturës “Mensur Zyberaj”, kanë bërë përgatitjet e nevojshme teknike për realizimin e dokumentarit “Dëshmi të heshtura” me autor.
- Biblioteka komunale “Sulejman Krasniqi”, ka pranuar një donacion librash 920 ekzemplarësh, tituj të ndryshëm, librat kryesisht janë në gjuhën gjermane dhe shqipe, donacioni ishte nga qendra rinore SHL-Kosova në Rahovec.
- Kanë rifilluar punimet e mbetura në riparimin e sallës në objektin e qendrës së kulturës “Mensur Zyberaj”,
- Kemi përcjellë të gjitha aktivitetet përkujtimore në nderim të të rënëve për liri në fshatrat e komunës sonë (mars-prill).
- Kanë vazhduar përgatitjet teknike për festivalin e folklorit “Anadrinia jehon 2018” në Dejnë.
- Përgatitjet me SHL-Kosova për debatin “Siguria në shkollë”.
- Shënim i Ditës Botërore të Monumenteve të Kulturës, aktiviteti u mbajt në muzeun komunal, pjesëmarrës nxënës të shkollës së mesme “Xhelal Hajda-Toni” dhe qytetarë, u bë prezantimi i pasurisë dhe i vlerave të trashëgimisë kulturore të Rahovecit.
- Promovimi i librit monografik “Antikiteti i Rahovecit” nga Sheqajdin Durguti.
- Debat “Siguria në shkollë” (SHL-Kosova, DKA, DKRS) panelist përfaqësues nga DKRS.
- Përgatitjet për shënimin e Ditës Botërore të Tokës, më 22 prill.
- Përgatitjet për shënimin e 30-vjetorit të formimit të KRR të LPRK-së.
- Në bashkëpunim me shkollën e muzikës “Falk Sylka”, prej 2-4 maj, u mbajt festivali ndërkombëtar për talent të rinj.
- Nga 5-12 maj 2018, Java e Dëshmorëve (OVL-UÇK, SHL-Kosova),
- Më 8.05.2018, hartimi dhe dorëzimi i rekomandimeve kryetarit të Komunës të nxjerra nga debati i 19 prillit me nxënës dhe mësime të DKA, DKRS dhe SHL-Kosova (Projekti: Siguria në shkollë),
- Më 11.05.2018, Ora poetike - kolazh poetik për dëshmorët (SHL-Kosova, shkollat e mesme e fillore dhe krijues të tjerë Qendra e kulturës "Mensur Zyberaj").

- Më 12.05.2018, Dita e Dëshmorëve (Komuna e Rahovecit, Shoqatat e dala nga UÇK, QK "Mensur Zyberaj"),
- 11-12-13 maj 2018, Festivali i folklorit në Dejnë - (Komuna e Rahovecit (DKRS) dhe Shoqata "Anadrini" Dejnë).
- 9-12 .05.2018 Garat në futboll të vogël në kuadër të Javës së Dëshmorëve, OVL-UÇK, drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.
- 22.05.2018 Debat me drejtorë të shkollave për sigurinë në shkollë, DKA, drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe SHL-Kosova.
- 23.05.2018 Formimi i Këshillit të nxënësve të komunës së Rahovecit, DKA, drejtoria për kulturë, Rini dhe Sport dhe SHL-Kosova.
- 28 maj, Kremtimi i ditës së qendrës së kulturës "Mensur Zyberaj" me aktivitete kulturore.
- Kremtimi i ditës ndërkombëtare të femijëve "1 Qershor", organizuar nga DKRS, Shoqata e gruas "Hareja". Koncert garues.
- 14 qershor - Dita e Çlirimit të komunës së Rahovecit, Aktivitete: Homazhe, akademi, program kulturo-artistik, gara në futboll.
- Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të muzikës; koncert organizuar në bashkëpunim me shkollën e muzikës "Faik Sylka".
- 19 qershor 2018, formimi i Këshillit të Veprimit Rinor Lokal (KVRL).
- 22 qershor 2018, konstituimi i kryesisë së KVRL-së.
- Takime njohëse me grupe të shoqërisë civile me drejtuesen e re të DKRS-së, pas ndryshimeve në drejtim.
- Debatit rreth formimit të teatrit rinor në Rahovec
- Evidentimi i objekteve të trashëgimisë kulturore që kërkojnë ndërhyrjen instiucionale me fonde për renovim,
- Organizimi i debatit me të rinjtë rreth përfshirjes së të rinjve në aktivitete vullnetare
- Përgatitjet për festën tradicionale të vjeljes së rrushit "HardhFest".
- Takime konsultuese me shoqërinë civile për organizime të përbashkëta të aktiviteteve kulturore e sportive "HardhFest"
- Ora poetike në kuadër të "HardhFest". Morën pjesë poetë nga Rahoveci dhe nga komunat fqinje.
- Organizimi i një shfaqjeje teatrale nga grupi "Passion" nga Tirana,
- Pjesëmarrja në aksionin për pastrimin e ambientit – aksioni gjithpërfshirës (formimi i Task Forcës komunale)
- Përgatitjet për shënimin e "Javës olimpike" (bashkëpunimi me SHL-Kosova dhe Shoqatën e Pedagogëve të kulturës fizike.
- Pjesëmarrja në lansimin e ndërmarrjeve sociale për qendrat rinore (përfutese shoqata e gruas "Hareja" taksi për gratë)
- Angazhime për sigurimin e fondeve të IPA-s për trashëgiminë kulturore. Partneriteti ndërkufitar Rahovec-Suharekë-Tearcë.
- Angazhime për luftimin e dukurive asociale në shkollat e komunës së Rahovecit (DKRS-DKA- SHL-K).
- Formimi i Këshillit Organizues për shënimin e ditëlindjes së shkrimtarit Sulejman Krasniqi, (8.11.2018).
- Eshhtë bërë pranimi i një kositëse të barit, për stadiumin e qytetit në Rahovec. Projekt i cili ka filluar në 2018.
- Angazhime për shënimin e festave të Nëntorit dhe përgatitja e aktiviteteve nga stafi i DKRS-së,
- Eshhtë nënshkruar kontrata me titull: "Riparimi i Shtëpisë së Kulturës në Ratkoc".
- Eshhtë nënshkruar kontrata me titull: "Riparimi i Monumenteve Kulturore Historike".
- Ekspozitë "Antikiteti i qytetit të Rahovecit" me autor z. Sheqajdin Durguti.
- Promovimi i librit "Përballje me jetën" autor Qendrim Gashi.

- Biblioteka e qytetit të Rahovecit "Sulejman Krasniqi" është pasuruar me 384 tituj librash të ndryshëm, duke pasuruar kështu fondin librar të kësaj biblioteke. Aktualisht, biblioteka e qytetit posedon 1152 ekzemplarë të rinj.
- Është aprovuar kërkesa kryetarit të komunës së Rahovecit, për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme "Pasuri Shtetërore e Kosovës, KK. Rahovec". Prona jepet në shfrytëzim me qëllim të ndërtimit të një stadiumi për futboll, fushë për hendboll, fushë për volejboll, fushë për tenis dhe për pjesë tjera për rekreacion. Komuna është duke i zhvilluar të gjitha procedurat për t'i përmbushur të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.
- Shfaqja e filmave vizatimor në Shtëpinë e Kulturës në Qytet, ka rezultuar me sukses, me rreth 300 fëmijë në qytet. Në Shtëpinë e Kulturës në Ratkoc, rreth 150 fëmijë, ndërsa në Krushe të Madhe rreth 60 fëmijë.
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ka pranuar një donacion kombi nga SHL për nevojat e klubeve sportive.
- Më 28 nëntor 2018, shënim i rikthimit të Skënderbeut në Krujë, Dita e Flamurit, dalja e UÇK-së, ditëlindja e Adem Jasharit,
- Më 7 dhjetor 2018 organizimi i Tryezës shkencore për Skënderbeun dhe ditëlindjen e shkrimtarit Sulejman Krasniqit.
- Komuna e Rahovecit ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, ku ministria do ta mbështesë me finalizim të projektit. Punimet janë duke vazhduar edhe përgjatë muajit dhjetor.
- Formimi i komisionit për përzgjedhjen e sportistëve të vitit 2018
- Shpallja e Sportistit të Vitit 2018, është realizuar më 31 dhjetor 2018.
- Përgatitja e raportit vjetor të punës dhe dorëzimi i raportit në Zyrën e Kryetarit të Komunës së Rahovecit.

Rahovec, dhjetor 2018